


REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/04/21;
Datë: 23.04.2021 .

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:


FTESË

Për: anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: Muharrem Krasniqi – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: mbledhja e tretë-(2021) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 30.04.2021, ora 14⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e muajt shkurt-2021,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Bartja e të hyrave vetanake të pa shpenzuar nga viti 2020 në vitin në 2021;
4. Raport i kryetarit të Komunës së Junikut rreth gjendjes ekonomiko-financiare të Komunës së Junikut ;
5. Propozim- vendimi për lrimin e bizneseve nga taksat komunale për vitin 2021, si masë përkrahëse për bizneset lokale në kohë pandemie;
6. Propozim për ndarjen e çmimit „Kuvendi i Junikut” për Heronjë dhe Dëshmorët e rënë në Komunën e junikut,
7. Të ndryshme



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	14.04.2021
PËR/ZA/TO:	Muharrem Krasniqi – Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Agron Kuçi - Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Kosovare Gacaferi- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2020 në vitin 2021

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nen 13, nen 58 dhe Statutit të Komunës së Junikut me Nr. 001/3127 të datës 29.09.2010 nen 43 dhe Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal kërkojmë që të bëhet bartja e të hyrave vetanake të shpenzuara nga viti 2020 në vitin 2021.

Në vitin 2020 janë planifikuar të inkasohen të hyra vetanake në vlerë prej **137,199.00€**, ndërsa shuma e inkasuar për vitin 2020 është **106,595.97€**. Të hyrat e bartura nga viti 2019 në vitin 2020 janë në vlerë prej **95,039.25 €** ku gjithsej të hyra në vitin 2020 janë **201,635.22 €**. Nga kjo shumë e të hyrave vetanake gjatë vitit 2020 janë shpenzuar gjithsej **169,805.07 €**.

Shuma e mbetur për bartje është **31,830.15 €** ku kërkojmë që bartja të bëhet në këtë kategori ekonomike si vijon:

- Shuma prej **31,830.15 €** të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në kodin 45605 për projektin “**Asfaltimi i rrugëve lokale**”, në Programin Planifikimi Urban dhe Mjedisi me kod 660, në nën Programin Planifikimi urban dhe inspeksioni me kod 66405.

Në total të hyra për bartje nga viti 2020 në vitin 2021 janë **31,830.15 €**



REPUBLICA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



DATE/A:	15.04.2021
REFERENC-Ë:	Nr. IV- 3/21
PËR/ZA/TO:	z.Muharrem Krasniqi – Kryesues në Kuvendin Komunal të Junikut
CC:	Anëtarët e Kuvendit Komunal në Junik
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Agron Kuçi – Kryetar i Komunës së Junikut
NGA/OD/FROM:	Leonard Lolluni – Drejtor për Zhvillim Ekonomik
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për propozim vendim për Bizneset në Komunën e Junikut

Të nderuar ,

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e mirë të deritanishëm, kërkojmë nga ana juaj që të nxirret një propozim vendim në lidhje me Bizneset të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Komunës së Junikut.



Të gjithë jemi në dijeni mbi vështirsitë që po kalojnë Bizneset në këtë periudhë pandemie nga Virusi SARS COVID 19, dhe ne si Drejtori, çdo vit ju dergojmë Bizneseve aktvendimet si vrejtje për shlyerje të borgjeve ndaj Komunës që rrjedhin nga rregullorja Komunale si taksë për ushtrim të veprimtarisë.

Në këtë periudhë Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për shkak të arsyes së cekur më lartë edhe pse i ka procesuar aktvendimet për shlyerje të borgjeve ndaj Komunës së Junikut që rrjedhin nga rregullorja Komunale, kërkojmë nga ana juaj që të nxirret një propozim vendim në lidhje me këtë qështje se si të veprojmë tutje, t'i lirojmë Bizneset nga taksa për ushtrim të veprimtarisë për vitin 2021 apo mos t'i lirojmë. Në rast të lirimit të Bizneseve nga taksa për ushtrim të veprimtarisë për vitin 2021, gjithashtu edhe bizneset që deri më tani i kanë shlyer obligimet e tyre ndaj Komunës së Junikut do të lirohen në vitin 2022. Në mbledhjen e bordit të drejtorëve të komunës së Junikut e cila kryesohet nga Kryetari i Komunës së Junikut, të gjithë unanimisht ishim për falje të taksës së cekur më lartë për vitin 2021, për shkak të gjendjes së vështirë që është krijuar nga Pandemia COVID 19.

Bashkangjitur në këtë kërkesë për propozim vendim e gjeni edhe tabelen me të dhëna për secilin Biznes që operon në Komunën e Junikut si dhe vlerën e taksës për vitin 2021, për secilin Biznes.


Ju faleminderit për bashkëpunimin.

Me respekt



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

REFERENC-Ë:	Nr. I-180/08/20
DATE:	16.04.2020
PËR/ZA/TO:	z.Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z.Agron Kuçi – Kryetar i Komunës së Junikut
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë



Bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040), neni 42, pika j) të Statutit të Komunës së Junikut, (Nr. 001/3127, të datës: 29.9.2010), neni 16 i rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës Junikut ju bëjmë këtë:

KËRKESË

Që të vendosni në rendin e ditës në mbledhjen e radhës së Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit Komunal kërkesën për:

Ndarjen e titullit “**Kuvendi i Junikut**” për **Heronjë**t dhe **Dëshmorët** e rënë në komunën e Junikut, për kontribut të veçantë, jetën dhe veprën në zhvillimin e proceseve historike-kombëtare si pjesëtar i UÇK-së,

Titulli “**Kuvendi i Junikut**”, është titulli i parë dhe më i lartë në Komunën e Junikut, i cili iu ndahet personaliteteve dhe institucioneve të veçanta, të cilët kanë dhënë kontribut të veçantë në zhvillimin e proceseve historike kombëtare, vlerave demokratike dhe universale.

Me respekt!